



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1756/₁ Prot

Tiranë, më 25/10/2022

VENDIM

Nr. 32, datë 25.10.2022

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Alterum” (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1756 Prot., datë 13.10.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Shoqërisë REMI TRANS sh.p.k.

Me shkresën datë 13.09.2022, ankuesi ka kërkuar nga Shoqëria REMI TRANS sh.p.k.:

1. Sa është numri i rasteve të aksidenteve që janë shkaktuar gjatë përdorimit të transportit publik në linjën që ju ofroni këtë shërbim gjatë periudhës 2016-2022?
2. Cilat kanë qenë shkaqet e aksidenteve dhe çfarë vendimesh janë marrë nga institucionet kompetente për aksidentet e ndodhura? Ju lutem na vendosni në dispozicion një kopje të vendimeve të institucioneve, psh. vendimi i gjykatës, prokurorisë, AKM-së, etj.
3. Si janë trajtuar rastet e aksidenteve nga ana e shoqërisë, a janë dëmshpërblyer personat që janë dëmtuar nga aksidenti? Nëse po, dëmshpërblimi është bërë me marrëveshje midis palëve apo nëpërmjet proceseve gjyqësore?
4. Sa është numri i kërkesave, ankesave që janë bërë nga qytetarët në lidhje me transportin publik për periudhën 2016-2022?
5. Cilat kanë qenë pretendimet dhe ankesat që kanë ngritur qytetarët?
6. Si janë trajtuar këto ankesa nga ana e shoqërisë që ofron shërbimin e transportit publik?

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, pasi Shoqëria REMI TRANS sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje për sa është kërkuar, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi...*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*” ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative Shoqërisë REMI TRANS sh.p.k.

Nga kërkimi i kryer në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Shoqëria REMI TRANS sh.p.k., është një shoqëri tregtare, me kuota 100% private, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në fushën e transportit urban dhe interurban.

Po ashtu, nga verifikimi në listën e Autoriteteve Publike që Zyra e Komisionerit mban në zbatim të LDI, Shoqëria REMI TRANS sh.p.k., nuk figuron në këtë listë.

Objekti i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike. Në kuptim të nenit 2, pika 1 e ligjit të sipërcituar “*Autoritet publik*”: a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Shoqëria REMI TRANS sh.p.k., nuk është autoritet publik, në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1756 Prot., datë 13.10.2022, të Qendrës “Alterum” kundër Shoqërisë REMI TRANS sh.p.k., me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 25.10.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

